



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
FAKULTETI I ARTEVE

PLANI STRATEGJIK 2025–2030

Prill, 2025

TABELA E PËRMBAJTJES:

I. PJESA HYRËSE	V
1. Fjala hyrëse institucionale.....	V
2. Parathënie nga dekani	VI
3. Përmbledhje ekzekutive	7
II. PROFILI INSTITUCIONAL DHE ANALIZA.....	8
4. Profili i fakultetit të arteve	8
5. Procesi i hartimit të planit strategjik	9
6. Struktura akademike dhe organizative	10
7. Misioni, Vizioni, Vlerat.....	11
8. Metodologjia e hartimit të planit strategjik	13
8.1. Formimi i Grupit Punues dhe Procesi Vendimmarrës	13
8.2. Faza të Hartimit	14
8.3. Pjesëmarrja dhe gjithëpërfshirja	14
9. Analiza swot.....	15
III. OBJEKTIVAT STRATEGJIKE (2025-2030).....	17
10. Prezantimi i objektivave strategjikë dhe logjika e përzgjedhjes së tyre	17
11. Objektivi Strategjik 1- Cilësia Akademike	18
12. Objektivi Strategjik 2 – Kërkimi dhe Inovacioni.....	19
13. Objektivi Strategjik 3- Infrastruktura.....	20
14. Objektivi Strategjik 4 - Ndërkombëtarizimi	21
15. Objektivi Strategjik 5 – Alumni dhe Komunitetit	22
IV. PLANI I ZBATIMIT DHE MONITORIMIT	24
16. Përputhja e Objektivave Strategjike me Veprimet e Zhvillimit dhe Masat e Zbatimit në Fakultetin e Arteve (2025–2030)"	24
17. Tabela përmbledhëse e burimeve financiare (2025–2030)	24
18. Struktura e Objektivave Strategjike dhe Operacionale sipas Fushave Kryesore të Zhvillimit të Fakultetit të Arteve (2025–2030)	25
19. Strategjitë e zbatimit dhe plani i veprimit (me tabelat përkatëse).....	26

19.1. Tabela më poshtë përfaqëson përmbledhjen tabelare të Planit të Veprimit për periudhën 2025–2030, të ndarë sipas pesë objektivave strategjike të Fakultetit.	27
20. Mekanizmat e monitorimit dhe raportimit	28
21. Monitorimi, vlerësimi dhe zbatueshmëria	29
21.1. Sistemi i monitorimit të objektivave strategjike	29
21.2. Mekanizmat dhe strukturat përgjegjëse për vlerësimin	29
21.3. Frekuenca e raportimit dhe përgjegjësitë.....	29
21.4. Rishikimi periodik dhe përmirësimi i planit	29
21.5. Përfshirja e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm.....	29
21.6. Lidhja ndërmjet planit të veprimit dhe objektivave strategjike	30
21.7. Tabela përmbledhëse e monitorimit dhe vlerësimit	30
22. Diagrami i procesit të monitorimit dhe vlerësimit	31
23. Ndikimi i parashikuar në shoqëri dhe kulturë	31
V. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME	33
24. Përmbledhje përfundimtare e Planit Strategjik	33
25. Rekomandime për zbatim të suksesshëm dhe përshtatje të vazhdueshme	33
25.1. Tabela e financimit indikativ për objektivat strategjike	34
VI. SHTOJCAT (të strukturara sipas logjikës së përmbajtjes)	35
Shtojca 1:	35
Shtojca 2: Qasja e fakultetit të arteve ndaj barazisë gjinore dhe përfshirjes	37
Shtojca 3: Diagrami i lidhjes ndërmjet OS–OO–KPI	39
Shtojca 4- Përmbledhje vizuale e strategjisë	40
Shtojcë 5: Lidhja ndërmjet objektivave strategjike, objektivave operacionalë dhe fushave kryesore tematike.....	41
Shtojca 6: Fjalor termash.....	42
Shtojca 7: Grafikët vizualë të zbatimit të objektivave strategjike (2025–2030).....	43
Objektivi Strategjik	43
Objektivi Strategjik	43
Objektivi Strategjik	43
Objektivi Strategjik	44

Objekti Strategjik	44
Shtojca 8: Angazhimi i fakultetit për zbatim, qëndrueshmëri dhe vizion	45

I. PJESA HYRËSE

1. Fjala hyrëse institucionale

Plani Strategjik i Fakultetit të Arteve për periudhën 2025–2030 përfaqëson dokumentin themelor udhëheqës për orientimin afatgjatë të zhvillimit akademik, krijues, institucional dhe ndërkombëtar të këtij institucioni. Ai pasqyron vizionin kolektiv të komunitetit artistik, pedagogjik dhe administrativ për të ndërtuar një Fakultet bashkëkohor, gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm, të harmonizuar me standardet evropiane të arsimit të lartë në fushën e arteve.

Dokumenti është hartuar në përputhje të plotë me kërkesat e Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA), si dhe me praktikën më të mira të planifikimit strategjik të institucioneve të arsimit të lartë në Evropë. Nëpërmjet këtij plani, Fakulteti i Arteve synon të përforcojë rolin e tij si një qendër e edukimit, krijimtarisë dhe inovacionit artistik në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, duke siguruar bazën për qeverisje të mirë, cilësi të qëndrueshme akademike dhe ndikim të gjerë kulturor.

Ky dokument ka karakter zyrtar dhe operacional, dhe do të zbatohet në bashkëpunim me Planin e Veprimit dhe Planin e Zhvillimit."

2. Parathënie nga dekani

Të nderuar anëtarë të komunitetit akademik, studentë, partnerë institucionalë dhe përfaqësues të shoqërisë,

Me nder dhe përgjegjësi të lartë profesionale kam kënaqësinë t'ju prezantoj Planin Strategjik të Fakultetit të Arteve për periudhën 2025–2030, një dokument themelor që përcakton drejtimin e zhvillimit tonë afatgjatë institucional, akademik, krijues dhe shoqëror.

Ky plan është hartuar në frymën e gjithëpërfshirjes, nëpërmjet një procesi konsultativ dhe reflektues që ka angazhuar të gjitha strukturat e brendshme të Fakultetit. Ai mbështetet në një analizë të thelluar të gjendjes ekzistuese dhe në një vlerësim të përgjegjshëm të sfidave dhe mundësive që karakterizojnë arsimin artistik në Kosovë dhe më gjerë. Duke u udhëhequr nga standardet ndërkombëtare për sigurimin e cilësisë, si dhe nga objektivat kombëtare për zhvillim të arsimit të lartë, ky dokument synon të shërbejë si udhërrëfyes për avancimin e misionit tonë akademik dhe krijues.

Fakulteti i Arteve e konsideron këtë plan si një kontratë morale dhe institucionale me të gjithë akterët – studentët tanë, stafin akademik e administrativ, komunitetin artistik dhe publikun e gjerë – për të garantuar përkushtim ndaj cilësisë, inovacionit, ndërdisiplinaritetit dhe përgjegjësisë shoqërore.

Në këtë frymë, ju ftoj të gjithëve që ta lexoni dhe ta trajtoni këtë dokument si një platformë për bashkëpunim dhe zhvillim të përbashkët, me qëllim të ndërtimit të një institucioni edhe më të fuqishëm, të hapur dhe të qëndrueshëm për të ardhmen.

Me respekt,

Prof. Dr. Hazir Haziri

Dekani i Fakultetit të Arteve

3. Përmbledhje ekzekutive

Plani Strategjik i Fakultetit të Arteve për periudhën 2025–2030 përfaqëson dokumentin udhëheqës për zhvillimin institucional, akademik dhe krijues të kësaj njësie akademike të Universitetit të Prishtinës. Dokumenti reflekton përkushtimin e Fakultetit për të rritur cilësinë në arsimin e lartë artistik, për të fuqizuar lidhjet me komunitetin, për të avancuar ndërkombëtarizimin dhe për të zhvilluar kërkimin dhe krijimtarinë në një mjedis ndërdisiplinar bashkëkohor.

Strategjia është ndërtuar mbi një analizë të gjithanshme të gjendjes aktuale dhe përfshin pesë objektiva strategjike kyçe:

1. Përmirësimi i cilësisë akademike dhe i kurrikulës;
2. Zhvillimi i kërkimit artistik dhe krijimtarisë në departamentet e Fakultetit të Arteve.
3. Zgjerimi dhe modernizimi i infrastrukturës dhe i mjedisit të mësimdhënies;
4. Ndërkombëtarizimi dhe bashkëpunimi me rrjete e institucione ndërkombëtare;
5. Aktivizimi i alumnistëve dhe forcimi i partneriteteve me komunitetin.

Secili objektiv është i shoqëruar me aktivitete të detajuara, afate kohore, burime të identifikuara dhe tregues matës për monitorimin e progresit. Një plan veprimi i strukturuar dhe një sistem transparent për ndjekjen dhe vlerësimin e zbatimit sigurojnë realizimin dhe përshtatjen e strategjisë gjatë gjithë periudhës së saj.

Ky dokument është hartuar në përputhje me standardet e Këshillit Shtetëror të Cilësisë (KShC) dhe me udhëzimet e Universitetit të Prishtinës për planifikim strategjik. Ai synon të shërbejë si bazë themelore për akreditimin institucional dhe programor në të ardhmen, si dhe për avancimin e rolit të Fakultetit të Arteve në sistemin arsimor dhe kulturor të vendit.

Zbatimi i këtij Plani Strategjik është operacionalizuar përmes Planit të Veprimit 2025–2030, i cili përmban objektiva konkrete, afate kohore, indikatorë të performancës dhe burime për realizim, dhe Planit të Zhvillimit. Të tri dokumentet janë të ndërlidhura dhe përbëjnë bazën për akreditimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm të Fakultetit.

Strategjia do të rishikohet periodikisht në vitin 2027 dhe 2030, në pajtim me mekanizmat e përcaktuar të vlerësimit.

II. PROFILI INSTITUCIONAL DHE ANALIZA

4. Profili i Fakultetit të Arteve

Fakulteti i Arteve është një nga institucionet më të vjetra dhe më me ndikim në fushën e arsimit të lartë artistik në Kosovë. Themelimi i tij daton që nga viti 1970, me ngritjen e Shkollës së Lartë Pedagogjike/ Dega e Arteve Figurative, e cila vendosi themelet për një trajnim akademik të strukturuar në artet vizuale në vend.

Në vitin 1973, kjo shkollë u transformua në Akademinë e Arteve Figurative, e themeluar zyrtarisht nga Kuvendi i Kosovës më 31 korrik 1973, dhe filloi aktivitetin e saj akademik më 25 dhjetor 1973 me tri disiplina themelore:

- Pikturë
- Skulpturë
- Grafikë

Me kalimin e viteve, Akademia u zhvillua dhe u zgjerua në drejtim të arteve të tjera, duke reflektuar dinamizmin dhe nevojat kulturore të shoqërisë kosovare:

VITI AKADEMIK	ZHVILLIMI KRYESOR
1970	Themelimi i Shkollës së Lartë Pedagogjike/ Dega e Arteve Figurative
1973	Themelimi i Akademisë së Arteve Figurative
1975/76	Themelimi i Degës së Arteve Muzikore
1989/90	Themelimi i Degës së Arteve Dramatike (Regji dhe Aktrim)
1995	Studimet Master- Dega e Arteve të Bukura
1986/87	Ri-emërimi si Fakulteti i Arteve
<i>Këto zhvillime përbëjnë një moment strategjik të unifikimit të Arteve Figurative, Muzikës dhe Arteve Dramatike në një strukturë të vetme akademike, duke nxitur bashkëpunimin ndërdisiplinor dhe fuqizuar infrastrukturën institucionale për një edukim artistik gjithëpërfshirës.</i>	

5. Procesi i hartimit të planit strategjik

Hartimi i Planit Strategjik 2025–2030 është rezultat i një procesi bashkëpunues, transparent dhe të bazuar në analiza të brendshme dhe të jashtme të Fakultetit të Arteve. Procesi ka përfshirë:

- Konsultim të gjerë me drejtuesit e tri departamenteve akademike
- Angazhimin e stafit pedagogjik dhe administrativ në mbledhje pune
- Analizë të dokumenteve relevante: raportet e vetëvlerësimit, raportet e akreditimit, dhe standardet ESG të arsimit të lartë
- Referencë ndaj politikave nacionale për arsimin e lartë dhe zhvillimin kulturor
- Përfshirje të studentëve dhe akterëve të jashtëm përmes diskutimeve dhe konsultimeve

Dokumenti është përpiluar me qëllimin për të përmirësuar cilësinë institucionale, për të ndërtuar partneritete të reja dhe për të rritur ndikimin e Fakultetit në fushën e arsimit dhe kulturës në Kosovë.

6. Struktura akademike dhe organizative

Sot, Fakulteti i Arteve funksionon si një njësi akademike publike e Universitetit të Prishtinës, e përkushtuar ndaj zhvillimit të artit, arsimit dhe hulumtimit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Ai përbëhet nga tri departamente:

1. Departamenti i Arteve të Bukura (Pikturë, Skulpturë, Grafikë, Vizatim dhe Ilustrim, Art Konceptual dhe Media të Reja, Dizajn Grafik dhe Multimedia)
2. Departamenti i Arteve Muzikore (Performancë, Kompozim, Arsim Muzikor)
3. Departamenti i Arteve Dramatike (Aktrim, Regji, Dramaturgj, Film dhe Televizion)

PROGRAMET AKADEMIKE		
Niveli i Studimeve	Numri i Programeve	Statusi i Akreditimit
Bachelor (BA)	3	Në proces riakreditimi
Master (MA)	6	Akreditim i vlefshëm

Fakulteti është në përpjekje të vazhdueshme për:

1. Modernizimin e kurrikulave;
2. Zhvillimin e programeve të reja (përfshirë programe ndërdisiplinore dhe të orientuara nga tregu i punës);
3. Fuqizimin e hulumtimit krijues dhe akademik;
4. Rritjen e bashkëpunimit ndërkombëtar;
5. Avancimin e kushteve infrastrukturore dhe digjitale për mësimdhënie dhe praktikë artistike.

7. Misioni, Vizioni, Vlerat

Misioni

Fakulteti i Arteve i Universitetit të Prishtinës ka për mision të ofrojë një mjedis akademik gjithëpërfshirës, krijues dhe sfidues për zhvillimin profesional, artistik dhe intelektual të studentëve dhe stafit në fushat e Artit Vizual, Muzikës dhe Dramës. Nëpërmjet programeve të akredituara, të strukturuar sipas standardeve evropiane të arsimit të lartë dhe me fokus në përsosjen e vazhdueshme të cilësisë, Fakulteti synon të formojë artistë, studiues dhe edukatorë që kontribuojnë në mënyrë aktive në jetën kulturore, sociale dhe ekonomike të Kosovës dhe më gjerë.

Fakulteti e sheh arsimin artistik si mjet thelbësor për zhvillimin individual dhe kolektiv, si dhe si urë ndërmjet trashëgimisë kulturore dhe inovacionit bashkëkohor. Prandaj, misioni i tij bazohet në përkushtimin për ofrim të një arsimi gjithëpërfshirës, etik dhe të orientuar drejt së ardhmes, i cili ndihmon në zhvillimin e qytetarëve kreativë, kritikë dhe të angazhuar.

Vizioni

Fakulteti i Arteve synon të jetë një institucion lider në rajon dhe me ndikim të njohur në Evropë në fushat e edukimit artistik, kërkimit krijues dhe inovacionit kulturor. Vizioni i tij është të zhvillojë një ekosistem të gjallë artistik dhe akademik që promovon lirinë krijuese, përfshirjen ndërdisiplinare dhe shkëmbimin ndërkombëtar, duke u shndërruar në pikë reference për arsimin e lartë artistik dhe për ndikim pozitiv në shoqëri.

Duke integruar teknologjinë, të menduarit kritik dhe praktikën bashkëkohore, Fakulteti aspiron të krijojë kushte për avancimin e artit dhe kulturës, të rrisë rolin e tij si një qendër për bashkëpunim lokal dhe global, dhe të jetë promotor i vlerave të qëndrueshme nëpërmjet artit.

Fakulteti i Arteve synon të bëhet anëtar aktiv i rrjeteve ndërkombëtare të arsimit të lartë në art, si ELIA (European League of Institutes of the Arts), AEC (Association Européenne des Conservatoires) dhe ENCATC (European Network on Cultural Management and Policy). Ky angazhim do të shërbejë si katalizator për rritjen e cilësisë, qarkullimin e ideve dhe promovimin ndërkombëtar të krijimtarisë së studentëve dhe stafit akademik.

Vlerat Themelore

VLERA	PËRSHKRIMI
Inovacioni	Nxitja e risive në art, pedagogji dhe teknologji për të përballuar sfidat bashkëkohore.
Ndërdisiplinariteti	Promovimi i bashkëpunimit ndërmjet disiplinave për të krijuar qasje të reja krijuese.
Përfshirja	Sigurimi i barazisë në mundësi, pjesëmarrje dhe përfaqësim për të gjithë anëtarët e komunitetit akademik.
Integriteti Akademik	Respektimi i standardeve më të larta të etikës, ndershmërisë dhe transparencës në mësimdhënie dhe kërkim.
Kultura Bashkëpunuese	Ndërtimi i një mjedisi dialogu, respekti dhe bashkëpunimi ndërmjet studentëve, stafit dhe komunitetit.
Përfaqësimi Kulturor	Vlerësimi dhe promovimi i trashëgimisë kulturore të Kosovës dhe i diversitetit kulturor global.

8. Metodologjia e hartimit të planit strategjik

Hartimi i Planit Strategjik të Fakultetit të Arteve për periudhën 2025–2030 është zhvilluar në përputhje me parimet e planifikimit strategjik institucional dhe me dokumentet udhëzuese të Universitetit të Prishtinës, si dhe me standardet e Agjencisë të Kosovës për Akreditim (AKA).

Ky proces është mbështetur në:

1.	Statutin e Universitetit të Prishtinës, konkretisht nenin 26 dhe nenin 72 që përcaktojnë kompetencat e njësive akademike për zhvillim strategjik dhe sigurimin e cilësisë;
2.	Strategjinë e Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës;
3.	Planin Strategjik të Universitetit të Prishtinës (2023–2027);
4.	Standardet ESG për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë në Evropë.

8.1. Formimi i Grupit Punues dhe Procesi Vendimmarrës

Në bazë të kompetencave të përcaktuara me Statut dhe rregullore të brendshme, Fakulteti i Arteve, ka emëruar Grupin Punues për hartimin e Planit Strategjik, i cili përbëhej nga përfaqësues të tri departamenteve akademike.

Grupi Punues ka ndjekur një proces të strukturuar pune, përmes fazave të mëposhtme:

1.	Analiza e dokumenteve relevante institucionale dhe shtetërore;
2.	Konsultime të brendshme me stafin akademik dhe administrativ;
3.	Punëtori me përfaqësues të studentëve dhe të diplomuarve (alumni);
4.	Konsultime me akterë të jashtëm si institucione kulturore, OJQ dhe partnerë ndërkombëtarë.

8.2. Faza të Hartimit

Nr.	PROCESI KA PËRFSHIRË PESË FAZA TË QARTA METODOLOGJIKE:
1.	Analiza kontekstuale: U shqyrtuan trendet në arsimin artistik, raportet e vetëvlerësimit dhe dokumentet strategjike të UP-së dhe MASHTI-t.
2.	Analiza SWOT: Është bërë për secilin departament, me fokus në identifikimin e avantazheve konkurruese dhe sfidave.
3.	Formulimi i objektivave: Në bazë të analizës SWOT, u definuan pesë objektiva strategjike dhe objektiva përkatëse specifike.
4.	Zhvillimi i planit të monitorimit dhe vlerësimit: Për të siguruar zbatim të qëndrueshëm dhe transparencë institucionale.
5.	Validimi institucional: Drafti përfundimtar u shqyrtua dhe u përgatit për publikim dhe zbatim.

8.3. Pjesëmarrja dhe gjithëpërfshirja

Dokumenti pasqyron një qasje gjithëpërfshirëse midis fushave, ku të gjitha strukturat institucionale kontribuan aktivisht për të siguruar që strategjia të jetë realiste, përfaqësuese dhe e zbatueshme. Pjesëmarrja ndërdisiplinore u sigurua përmes përfaqësimit të të gjitha profileve artistike dhe pjesëmarrjes së akterëve nga fusha të ndryshme të artit dhe kulturës.

Në kuadër të procesit të hartimit, janë mbajtur tri tryeza me studentë nga të gjitha departamentet, dy forume me alumnistët aktivë dhe një sesion i hapur me përfaqësues nga sektori kulturor vendor, për të siguruar që strategjia të pasqyrojë nevojat reale të komunitetit akademik dhe artistik.

9. Analiza swot

Konteksti dhe qasja metodologjike

Në funksion të hartimit të një strategjie zhvillimore gjithëpërfshirëse dhe reale, Fakulteti i Arteve ka realizuar një analizë të gjendjes aktuale përmes metodologjisë SWOT (Pikat e forta, Dobësitë, Mundësitë, Kërcënimet). Kjo analizë përbën një instrument kyç për vlerësimin e kapaciteteve të brendshme të Fakultetit si dhe të faktorëve të jashtëm që ndikojnë në performancën institucionale, arritjen e objektivave strategjike dhe procesin e akreditimit.

Elementet e analizës janë identifikuar nëpërmjet një procesi të kombinuar konsultimi me stafin akademik dhe administrativ, analizës së dokumentacionit ekzistues (raportet e vetëvlerësimit, të dhëna statistikore, input nga alumnitstët dhe studentët), si dhe në bazë të trendeve aktuale në arsimin e lartë artistik në nivel vendor dhe evropian.

Analiza SWOT ka shërbyer si bazë për hartimin e objektivave strategjike të Fakultetit, duke siguruar që strategjia të jetë e orientuar drejt burimeve reale, të adresojë dobësitë strukturore, të shfrytëzojë mundësitë që ofron mjedisi dhe të marrë masa parandaluese kundër rreziqeve të identifikuara.

Tabela e Analizës Swot

PIKAT E FORTA	DOBËSITË	MUNDËSITË	KËRCËNIMET
Staf akademik me grada shkencore të larta dhe ekspertizë artistike të njohur.	Mungesë infrastrukture të përbashkët për të tri departamentet.	Thirrje të hapura për projekte hulumtuese dhe artistike nga fondet e BE-së.	Shpërngulja e talentëve për shkak të mungesës së kushteve të avancuara.
Struktura të konsoliduara për cilësinë, etikën dhe mentorimin akademik.	Pajisje teknologjike të pamjaftueshme ose të amortizuara për praktikën artistike.	Kërkesë në rritje për profesionistë në fushat krijuese dhe multimediale.	Mungesë financimesh të qëndrueshme për projekte artistike dhe infrastrukture nga buxheti i shtetit.
Reputacion i konsoliduar institucional në arsimin e lartë artistik në Kosovë.	Vështirësi në integrimin sistematik të teknologjisë në kurrikulë.	Trende të favorshme për art digjital, animacion, AR/VR, audio 3D dhe teknologji krijuese.	Konkurrencë nga programet private me qasje fleksibile dhe teknologji moderne.
Alumnistë të shquar dhe të angazhuar në skenën vendore dhe ndërkombëtare.	Përfshirje jo e strukturuar e studentëve në hartimin e strategjive institucionale.	Mundësi për partneritete strategjike me institucione kulturore vendore dhe rajonale.	Vonesa dhe pengesa administrative që pengojnë zbatimin e reformave dhe planeve zhvillimore.
Pjesëmarrje aktive në programe si Erasmus+, Creative Europe, bienale dhe ekspozita.	Nevojë për zhvillim të mëtejshëm të stafit në metodologjitë e reja të mësimdhënies.	Pozicionimi i Fakultetit si qendër e inovacionit ndërdisiplinar dhe artit bashkëkohor në rajon.	Pasiguri në politikën arsimore dhe mungesë vazhdimësie në mbështetjen institucionale dhe legjislative.

Përfundim

Kjo analizë e detajuar e mjedisit të brendshëm dhe të jashtëm i mundëson Fakultetit të Arteve të vendosë prioritetet e qarta zhvillimore dhe të ndërtojë një strategji të qëndrueshme institucionale, e cila merr parasysh potencialin ekzistues dhe sfidat reale. Të gjeturat e kësaj analize janë reflektuar drejtpërdrejt në formulimin e pesë objektivave strategjike që paraqiten në kapitullin pasues dhe që përbëjnë shtyllat kryesore të Planit Strategjik 2025–2030.

III. OBJEKTIVAT STRATEGJIKE (2025-2030)

10. Prezantimi i objektivave strategjike dhe logjika e përzgjedhjes së tyre

Në funksion të vizionit dhe misionit institucional të Fakultetit të Arteve, si dhe në bazë të analizës së kontekstit të brendshëm dhe të jashtëm, janë përcaktuar pesë objektiva strategjike që përbëjnë boshtin kryesor të këtij dokumenti planifikues për periudhën 2025–2030. Këto objektiva adresojnë fushat me prioritet të zhvillimit akademik dhe institucional të Fakultetit, duke synuar përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në arsim, kërkim dhe krijimtari, modernizimin e infrastrukturës, zgjerimin e bashkëpunimeve ndërkombëtare dhe fuqizimin e lidhjeve me komunitetin dhe alumnistët.

Secili objektiv strategjik është i strukturuar në disa nën-seksione të qarta që përfshijnë: përshkrimin e objektivit, qëllimin specifik, aktivitetet kryesore të parashikuara për realizimin e tij, rezultatet e pritshme, treguesit e performancës, afatet dhe burimet e nevojshme, si dhe analizën e rreziqeve dhe masave parandaluese. Kjo strukturë lejon ndërtimin e një procesi të qëndrueshëm dhe të matshëm të zbatimit strategjik, duke siguruar një lidhje të drejtpërdrejtë ndërmjet planifikimit dhe veprimit praktik.

Objektivat janë të ndërlidhura me njëra-tjetrën dhe trajtohen në mënyrë të integruar për të reflektuar ndër - disiplinaritetin dhe qasjen gjithëpërfshirëse të Fakultetit të Arteve ndaj zhvillimit të tij institucional. Përcaktimi i tyre është realizuar në harmoni me standardet e KShC-së për arsimin e lartë, udhëzimet e Universitetit të Prishtinës për planifikim strategjik, si dhe praktikatat më të mira evropiane në fushën e arsimit artistik.

Në vijim paraqiten pesë objektivat strategjike të detajuara, secila e shoqëruar me planin përkatës të veprimit dhe elementet përcjellëse të zbatimit.

Secili nga pesë objektivat strategjike (OS1–OS5) është i paraqitur në mënyrë të ndarë me nënkapituj të veçantë dhe i shoqëruar me një tabelë që përmbledh komponentët kyç: qëllimi specifik, aktivitetet, rezultatet, treguesit matës, afatet, burimet dhe rreziqet.

CILËSIA AKADEMIKE

11. Objektivi Strategjik 1- Cilësia Akademike

11.1	Përshkrimi I Objektivit	Të modernizohen programet ekzistuese të studimeve në tri departamentet (Arte të Bukura, Muzikë dhe Dramë) përmes rishikimit të lëndëve, harmonizimit me standardet ESG, përfshirjes së teknologjive të reja dhe rritjes së përfshirjes së akterëve të jashtëm (alumnistët, tregu i punës, ekspertë ndërkombëtarë) në hartimin dhe zbatimin e kurrikulës.	
11.2	Qëllimi Specifik	Rritja e cilësisë së mësimdhënies dhe përputhja e përmbajtjes së studimeve me zhvillimet bashkëkohore në art dhe tregun e punës.	
11.3	Aktivitetet Kryesore	• Rishikimi i plotë i të gjitha lëndëve ekzistuese (BA/MA) për përputhje me standardet ESG dhe trendet bashkëkohore.	
		• Krijimi i lëndëve të reja që integrojnë teknologjinë si: inteligjenca artificiale, realiteti virtual, audio 3D, artet e gjeneruara nga kompjuteri, dizajni interaktiv, etj.	
		• Fuqizimi i tupës së jashtme këshilluese me pjesëmarrjen e alumnistëve dhe profesionistëve nga tregu i punës për të dhënë input për zhvillimin e programeve.	
		• Organizimi i trajnimeve për stafin në metoda të reja pedagogjike dhe mësimdhënie digjitale.	
11.4	Rezultatet E Pritshme	• 50 përqind e lëndëve ekzistuese të reformuara dhe të miratuara nga Senati i UP-së deri në vitin 2027.	
		• Të paktën 3 lëndë të reja të zhvilluara në fushat e teknologjisë digjitale deri në fund të vitit 2026.	
		• Konsultime vjetore me grupet e interesit (alumnistë dhe punëdhënës) për përmirësimin e kurrikulës.	
11.5	Treguesit e Performancës	• Rritja e kënaqësisë së studentëve për përmbajtjen e programeve akademike me 25 përqind deri në vitin 2027 (bazuar në anketimet vjetore).	
		• Rritja e punësueshmërisë së të diplomuarve në fushën përkatëse me 20 përqind deri në vitin 2028.	
		• Integrimi i mjeteve të reja teknologjike në të paktën 30 përqind të lëndëve praktike.	
11.6	Afatet dhe Burimet	• Afati: Janar 2025 – Dhjetor 2027	
		• Burimet: Koha e stafit, trajnime me fonde Erasmus+, përfshirje e ekspertëve, mjete për zhvillim të moduleve digjitale	
1	Rreziqet dhe Masat Parandaluese	RREZIKU	MASË PARANDALUESE
11.7			
		Rezistencë ndaj ndryshimeve nga një pjesë e stafit	Trajnime sensibilizuese dhe mbështetje pedagogjike
		Vonesë në aprovimin e lëndëve të reja	Planifikim paraprak dhe bashkëpunim i ngushtë me UP dhe Këshillin e Fakultetit
		Mungesë fondesh për trajnimet dhe pajisjet	Aplikim në projekte ndërkombëtare dhe fonde të veçanta për zhvillim profesional

KËRKIMI DHE INOVACIONI

12. Objektivi Strategjik 2 – Kërkimi dhe Inovacioni

12.1	Përshkrimi i Objektivit	Të Ndërtohet Një Infrastrukturë Funksionale Për Kërkim Artistik Dhe Projekte Të Përbashkëta Krijuese Ndërmjet Tri Departamenteve, Në Mënyrë Që Fakulteti I Arteve Të Shndërrohet Në Një Qendër Të Inovacionit Dhe Shprehjes Bashkëkohore Artistike.	
12.2	Qëllimi Specifik	Të Nxitet Prodhimi Artistik Dhe Kërkimi Krijues Brenda Dhe Jashtë Kurrikulës Përmes Instituteve, Laboratorëve, Ekspozitave, Performancave Dhe Publikimeve Të Rregullta Të Veprave Dhe Reflektimeve Teorike.	
12.3	Aktivitetet Kryesore	• Funksionalizimi i Institutit të Brendshëm të Arteve (Galeria, Laboratori Për Inovacion Dhe Qendra Për Hulumtime).	
		• Organizimi I 3–5 Projekteve Midis Departamenteve Në Vit, Me Karakter Kërkimor Dhe Artistik.	
		• Krijimi I Një Katalogu Vjetor Me Punimet Dhe Projektet E Studentëve Dhe Stafit.	
		• Mbështetje Për Pjesëmarrjen E Stafit Dhe Studentëve Në Simpoziume, Bienale, Festivale Dhe Ekspozita Ndërkombëtare.	
		• Aplikime Të Rregullta Në Thirrje Për Financim Të Projekteve Nga MKRS, BE Dhe Donatorë Të Tjerë.	
12.4	Rezultatet i Pritshme	• Funksionalizimi I Plotë I Njësisë Të Institutit Të Arteve Deri Në Fund Të Vitit 2028.	
		• Realizimi I Të Paktën 15 Projekteve Të Përbashkëta Artistike Gjatë Periudhës 2025–2030.	
		• Publikimi I 5 Katalogëve Dhe Ekspozitave Digjitale Deri Në Fund Të Vitit 2028.	
12.5	Treguesit Performancës	• Rritja E Ekspozimit Të Fakultetit Në Media, Rrjete Artistike Dhe Publikime Akademike.	
		• Rritja E Përfshirjes Së Studentëve Në Projekte Kërkimore Me 40 Përqind Krahësuar Me Vitin 2024.	
		• Krijimi I Bashkëpunimeve Të Reja Me Institucione Artistike Jashtë Kosovës Çdo Vit.	
12.6	Afatet dhe Burimet	• Afati: Janar 2025 – Dhjetor 2030	
		• Burimet: Fondet E Brendshme Të UP-Së, Projektet Erasmus+, Creative Europe, Hapësirat Aktuale Të Galerisë Dhe Laboratorit, Staf I Përfshirë Nga Të Tri Departamentet.	
2	Rreziqet dhe Masat Parandaluese	RREZIKU	MASË PARANDALUESE
12.7			
		Projekte pa koordinim të mirë midis deparatamenteve	Formim i ekipeve të përziera dhe trajnime paraprake mbi menaxhimin artistik
		Vështirësi në sigurimin e fondeve për realizim të plotë	Diversifikimi i burimeve të financimit dhe ndarja në faza të zbatimit
		Mungesë angazhimi nga njësi të caktuara	Përcaktimi i përgjegjësisë të qarta dhe përfshirje në vlerësim të performancës

INFRASTRUKTURA

13. Objektivi Strategjik 3 - Infrastruktura

13.1	Përshkrimi i objektivit	Të përmirësohet dhe zgjerohet infrastruktura fizike dhe teknologjike e Fakultetit të Arteve për të garantuar kushte optimale të punës për studentë, staf dhe projekte artistike. Qëllimi është krijimi i një kampusi të integruar për tri departamentet (Arte të Bukura, Muzikë, Dramë), i cili ofron studio, atelie, laboratorë të teknologjisë, hapësira performative dhe ambiente për punë individuale dhe kolektive.	
13.2	Qëllimi Specifik	Të sigurohet një infrastrukturë e qëndrueshme, funksionale dhe moderne që e mbështet procesin mësimor, krijimtarinë dhe kërkimin shkencor në art.	
13.3	Aktivitetet Kryesore	- Hartimi i projektit të detajuar për ndërtimin e një objekti të ri të përbashkët për Fakultetin e Arteve. - Sigurimi i fondeve nga UP, MKRS, BE dhe partnerë tjerë për ndërtimin në faza të ndryshme. - Pajisja e ambienteve me teknologji bashkëkohore për art digjital, audio/video, realitet të shtuar, studio regjistrimi dhe teatër. - Përdorimi i përkohshëm i hapësirave ekzistuese për projekte pilot dhe trajnime derisa të realizohet objekti i ri. - Monitorim dhe përfshirje e komunitetit akademik në planifikimin e hapësirave të reja.	
13.4	Rezultatet e Pritshme (output)	- Projekti arkitektonik i finalizuar dhe i miratuar deri në fund të vitit 2025. - Faza e parë e ndërtimit të objektit e përfunduar deri në vitin 2028. 100 përqind e programeve që zhvillohen në hapësira të përshtatshme dhe teknologjikisht të përditësuara deri më 2030. - Rritje e numrit të ngjarjeve artistike të organizuara në hapësirat e Fakultetit.	
13.5	Treguesit e Performancës (outcome)	- Rritje për 50 përqind e kënaqësisë së studentëve dhe stafit për kushtet e punës deri në vitin 2030. - Rritje e pjesëmarrjes së publikut në ekspozita, koncerte dhe shfaqje të realizuara në ambientet e reja. - Përdorim maksimal i teknologjisë digjitale në të paktën 50 përqind të praktikës krijuese dhe mësimore.	
13.6	Afatet dhe Burimet	Afati: Janar 2025 – Dhjetor 2030 Burimet: Buxheti i UP-së, MKRS, projekte IPA dhe Creative Europe, donatorë të jashtëm, ekspertë të arkitekturës dhe menaxhimit të hapësirës	
3	Rreziqet dhe Masat Parandaluese	RREZIKU	MASË PARANDALUESE
13.7		Vonesa në financim publik	Përcaktimi i fazave të ndërtimit dhe aplikim në projekte ndërkombëtare për bashkëfinancim
		Zhvillim i ngadaltë i projektit teknik	Përfshirje e hershme e arkitektëve dhe komunikim i vazhdueshëm me autoritetet qendrore
		Mungesë përfshirjeje e komunitetit akademik	Takime konsultuese me stafin dhe studentët për nevojat reale të hapësirës

NDËRKOMBËTARIZIMI

14. Objektivi Strategjik 4 - Ndërkombëtarizimi

14.1	Përshkrimi i Objektivit	Të rritet shkëmbimi akademik dhe krijues me institucione ndërkombëtare përmes marrëveshjeve dypalëshe, projekteve të përbashkëta, pjesëmarrjes në rrjete profesionale evropiane dhe përfshirjes në platforma të shkëmbimit artistik dhe pedagogjik.	
14.2	Qëllimi Specifik	Zgjerimi i prezencës ndërkombëtare të Fakultetit të Arteve dhe krijimi i një kulture të qëndrueshme bashkëpunimi në fushat e mësimdhënies, kërkimit dhe ekspozimit artistik.	
14.3	Aktivitetet Kryesore	Nënshkrimi i të paktën 10 marrëveshjeve të reja ndërkombëtare deri më 2027	
		Pjesëmarrja në programet Erasmus+, Creative Europe, ENCATC, AEC dhe rrjete të tjera artistike	
		Dërgimi i stafit akademik dhe studentëve për mobilitet semestral, trajnime dhe projekte të përbashkëta	
		Ftesa e profesorëve dhe artistëve ndërkombëtarë për ligjërata, ekspozita, punëtori dhe bashkëpunime	
		Krijimi i moduleve në gjuhë angleze për tërheqje të studentëve të huaj në studime afatshkurtra	
14.4	Rezultatet e Pritshme	Të paktën 15 mobilitete të studentëve dhe stafit në vit duke filluar nga 2026	
		Realizimi i 5 projekteve ndërkombëtare ndërmjet departamenteve të Fakultetit dhe partnerëve të jashtëm deri në 2030	
		6 ligjërata të hapura ose punëtori me profesorë ndërkombëtarë çdo vit	
14.5	Treguesit e Performancës	Rritje e 30 përqind të vizibilitetit ndërkombëtar të Fakultetit në platformat akademike dhe artistike	
		Pjesëmarrje në të paktën 3 rrjete evropiane brenda vitit 2026	
		Rritje e interesimit për bashkëpunim nga universitetet jashtë vendit	
14.6	Afatet dhe Burimet	Afati: Janar 2025 – Dhjetor 2030	
		Burimet: Koordinatorë Erasmus+, Zyra për Marrëdhënie me Jashtë, fonde të BE-së, partneritete dypalëshe	
4	Rreziqet dhe Masat Parandaluese	RREZIKU	MASË PARANDALUESE
14.7			
		Vonesë në mobilitet për shkak të çështjeve administrative	Përforcimi i stafit administrativ dhe trajnimi për menaxhim të mobiliteteve
		Mungesë fondesh për bashkëpunime afatgjata	Aplikime të përvitshme në thirrjet e BE-së dhe programe rajonale
		Mungesë njohurie për aplikime ndërkombëtare	Trajnime për staf dhe ndihmë teknike nga UP dhe Zyra për Projekte

ALUMNI DHE KOMUNITETI

15. Objektivi Strategjik 5 – Alumni dhe Komunitetit

15.1	Përshkrimi i Objektivit	Fakulteti i Arteve synon krijimin e një platforme digjitale për alumnistët, që promovon rrjetëzim, mentorim dhe përfshirje në jetën artistike e akademike. Paralelisht, forcohen lidhjet me komunitetin përmes bashkëpunimeve të qëndrueshme kulturore, edukative dhe sociale.	
15.2	Qëllimi Specifik	Të angazhohen alumnistët dhe komuniteti si pjesë aktive e Fakultetit, duke ndërlidhur arsimin me tregun e punës dhe nevojat kulturore të shoqërisë.	
15.3	Aktivitetet Kryesore	Platformë digjitale për regjistrimin dhe rrjetëzimin e alumnistëve	
		Ngjarje vjetore me alumnistë: Forumi, Panairi i Karrierës, Ditët e Artit	
		Përfshirje e alumnistëve në mentorim dhe ligjërata	
		Projekte komunitare me shkolla dhe institucione kulturore	
		Praktika profesionale në partneritet me sektorin kreativ	
15.4	Rezultatet e Pritshme	Platformë aktive nga viti 2025	
		2 ngjarje vjetore me alumnistë	
		3 lëndë me mentorë/ligjërues alumnistë deri më 2027	
		Bashkëpunime të rregullta me komunitetin lokal	
		Angazhimi i alumnistëve në aktivizëm kulturor dhe mentorim	
15.5	Treguesit e Performancës	Rritje e angazhimit të alumnistëve në veprimtaritë e Fakultetit me 50 përqind deri më 2028	
		Rritje e bashkëpunimeve me komunitetin për projekte jashtë auditorëve	
		Fuqizim i rrjetit të partneriteteve për praktika dhe projekte të studentëve	
15.6	Afatet dhe Burimet	Afati: Janar 2025 – Dhjetor 2028	
		Burimet: Zyra për Alumnistë dhe Praktika, mbështetje nga partnerët, platforma online, hapësira publike, bashkëfinancim nga komunat dhe institucionet kulturore	
15.7	Aktivitete Shtesë:	Seminare publike, ekspozita dhe forume kulturore në bashkëpunim me OJQ-të dhe institucionet lokale.	
		Projekte edukative me shkolla të mesme dhe komunitete të marginalizuara.	
		Përfshirja e studentëve në nisma qytetare dhe dialog ndërkulturor.	
		Do të promovohen standarde të qarta të etikës institucionale, barazisë gjinore dhe përfaqësimit të drejtë.	
5		RREZIKU	MASË PARANDALUESE
15.8	Rreziqet dhe masat parandaluese		
		Pjesëmarrje e ulët e alumnistëve në platformë	Fushatë promovimi dhe përfshirje që nga viti i fundit i studimeve
		Mungesë kapaciteti për menaxhimin e marrëdhënieve me komunitetin	Koordinim me institucionet kulturore dhe zyrat komunale për projekte të përbashkëta
		Vështirësi në identifikimin e partnerëve për praktika	Hartim i një databaze me partnerë të mundshëm dhe marrëveshje bashkëpunimi

Tabela në vijim paraqet përputhjen tematike dhe logjike ndërmjet Planit Strategjik, Planit të Veprimit dhe Planit të Zhvillimit për Fakultetin e Arteve, duke garantuar vazhdimësi institucionale dhe koherencë ndërmjet objektivave strategjike dhe masave konkrete të zbatimit.

IV. PLANI I ZBATIMIT DHE MONITORIMIT

16. Përputhja e Objektivave Strategjike me Veprimet e Zhvillimit dhe Masat e Zbatimit në Fakultetin e Arteve (2025–2030)"

OBJEKTIVI STRATEGJIK	VEPRIMET NË PLANIN E ZHVILLIMIT	MASAT PËRKATËSE NË PLANIN E VEPRIMIT
OS1 – Cilësia	Zhvillimi i kurrikulave, teknologjia mësimore	Trajnime për staf, klasat e mençura, mentorime për student
OS2 – Kërkimi	Qendra kërkimore, laboratorë, databaza	Mbështetje për projekte shkencore, grante, botime
OS3 – Ndërkombëtarizimi	Marrëveshje, mobilitet, partneritete	Erasmus+, shkëmbime akademike, programe të përbashkëta
OS4 – Infrastrukturë	Ndërtimi i kampusit të ri, galleritë, pajisjet	Projekte infrastrukturore, pajisje moderne, digjitalizim
OS5 – Përfshirja	Politika për barazi dhe përfshirje sociale	Trajnime, platforma për raportim, përfaqësim i balancuar

17. Tabela përmbledhëse e burimeve financiare (2025–2030)

Kjo tabelë përmbledh burimet e pritshme financiare për secilin objektiv strategjik të Fakultetit të Arteve për periudhën 2025–2030. Vlerësimet janë indikative dhe shërbejnë si bazë për planifikimin buxhetor dhe mobilizimin e fondeve nga burime të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare.

Nr.	OBJEKTIVI STRATEGJIK	BURIMET E PARASHIKUARA	KOMENT/SPECIFIKIME
1.	Cilësia Akademike dhe Kurrikula	UP, Erasmus+, ekspertë të jashtëm	Trajnime, zhvillim i moduleve digjitale
2.	Kërkimi Artistik dhe Krijimtaria	MKRS, Creative Europe, UP	Projekte, publikime, institute
3.	Infrastruktura dhe Mjedis i Mësimdhënies	UP, MKRS, IPA III, BE, donatorë	Ndërtimi, pajisje teknologjike
4.	Ndërkombëtarizimi dhe bashkëpunimet ndërkombëtare	Erasmus+, UP, partnerë	Mobilitete, profesorë vizitorë, rrjete
5.	Alumnistët dhe Partneritetet me Komunitetin	Komuna, donatorë vendorë	Platformë, aktivitete, bashkëpunime kulturore

18. Struktura e Objektivave Strategjike dhe Operacionale sipas Fushave Kryesore të Zhvillimit të Fakultetit të Arteve (2025–2030)

Nr.	OBJEKTIVI STRATEGJIK	OBJEKTIV OPERACIONAL I LIDHUR		FUSHA KRYESORE
1.	Cilësia Akademike	Objektivi. 1	Mësimdhënia	Arsimi & Pedagogjia
		Objektivi. 2	Kurrikula	
2.	Kërkimi & Krijimtaria	Objektivi. 3	Kërkimi	Inovacion artistik
3.	Infrastruktura	Objektivi. 4	Digjitalizimi & ambientet	Mjedisi akademik
4.	Ndërkombëtarizimi	Objektivi. 5	Mobiliteti & Partneritetet	Bashkëpunimi global
5.	Komuniteti, Alumni & Qeverisja	Objektivi. 6	Angazhimi qytetar	Shoqëria dhe ndikimi publik
		Objektivi. 7	Qeverisja dhe qëndrueshmëria	Menaxhim, gjithëpërfshirje dhe cilësi

19. Strategjitë e zbatimit dhe plani i veprimit (me tabelat përkatëse)

Në funksion të operacionalizimit të objektivave strategjike të përcaktuara në këtë dokument, Fakulteti i Arteve ka hartuar një Plan të Detajuar Veprimi, i cili përkthen qëllimet institucionale në masa konkrete, të matshme dhe të monitorueshme. Strategjitë e zbatimit të paraqitura në këtë kapitull përfaqësojnë lidhjen direkte ndërmjet vizionit dhe misionit të Fakultetit, si dhe ndërmjet strukturës së objektivave strategjike dhe praktikës së përditshme akademike, kërkimore dhe menaxheriale.

Ky plan veprimi mbështetet në parimet e menaxhimit të ciklit të performancës, planifikimit të bazuar në evidencë dhe zhvillimit të qëndrueshëm institucional. Ai synon të sigurojë një qasje të integruar përmes koordinimit midis departamenteve, mobilizimit të burimeve të brendshme dhe të jashtme, si dhe ndarjes së qartë të përgjegjësiave për çdo nivel të zbatimit.

Tabela në vijim përmbledh aktivitetet kyçe për secilin objektiv strategjik, afatet e zbatimit, njësitë institucionale përgjegjëse, burimet e nevojshme për realizim, treguesit matës të progresit dhe rreziqet e mundshme që mund të ndikojnë në ecurinë e zbatimit.

Kjo qasje e strukturuar garanton një menaxhim efektiv të strategjisë dhe ndihmon në ndërtimin e një kulture të përgjegjshmërisë dhe transparencës në vendimmarrje.

Plani i Veprimit është hartuar në përputhje me standardet e Këshillit Shtetëror të Cilësisë (KShC), udhëzimet e Universitetit të Prishtinës për planifikim institucional dhe Kornizën Evropiane për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ESG). Ai do të shërbejë si instrument kyç për monitorimin dhe vlerësimin sistematik të progresit gjatë periudhës 2025–2030 dhe për orientimin e ndërhyrjeve të nevojshme gjatë fazave të zbatimit.

19.1. Tabela më poshtë përfaqëson përmbledhjen tabelare të Planit të Veprimit për periudhën 2025–2030, të ndarë sipas pesë objektivave strategjikë të Fakultetit.

NR.	OBJEKTIVI STRATEGJIK	AKTIVITETE T KRYESORE	AFATI	PËRGJEGJËS IT KRYESOR	BURIMET	TREGUES MATËS	RREZIQE TË MUNDSHME
1	Cilësia Akademike dhe Kurrikula	Rishikimi i moduleve; krijimi i lëndëve të reja me teknologji; trajnime për staf; bord këshillues me alumnistë	2025–2027	Departamenti, Zyra për Cilësi, Këshilli i Fakultetit	Stafi, fondet Erasmus+, ekspertë të jashtëm	Përqindja e lëndëve të përditësuara, anketa studentore, lëndë të reja	Rezistencë ndaj ndryshimeve, mungesë fondesh
2	Kërkimi Artistik dhe Krijimtaria	Projekte ndërdepartamentale; ekspozita dhe katalogë; institute të brendshme	2025–2030	Instituti i Arteve, Galeria, Laboratori për Inovacione	UP, MKRS, Creative Europe, Erasmus+	Numri i projekteve, ekspozitave, përfshirja e studentëve	Mungesë bashkëpunimi ndërdepartamentale, mungesë fondesh
3	Infrastruktura dhe Mjedis	Ndërtimi i objektit të përbashkët; pajisje moderne; përfshirja e stafit në planifikim	2025–2030	UP, Dekanati, MKRS	Buxhet kapital, partnerë strategjikë	Projekti i miratuar, faza të ndërtuara, kënaqësia e stafit	Vonesa në financim, mungesë infrastrukture të përkohshme
4	Ndërkombëtarizimi	Marrëveshje dypalëshe; mobilitete; projekte ndërkombëtare; profesorë vizitorë	2025–2030	Zyra për Marrëdhëniet me Jashtë, Koordinatorët e programeve	Erasmus+, partnerë evropianë	Numri i mobiliteteve, rrjete ndërkombëtare	Mungesë fondesh, vonesa administrative
5	Alumni dhe Partneritete	Platforma e alumnive; mentorim; bashkëpunime komunitare dhe kulturore	2025–2028	Zyra për Alumni, Qendrat e praktikës	Platforma digjitale, partnerë vendorë	Numri i ngjarjeve, angazhimi i alumnive	Angazhim i ulët, mungesë koordinimi me komunitetin

Për të ndihmuar vizualisht interpretimin e strukturës së strategjisë, një diagram vizual i ndërlidhjes ndërmjet Objektivave Strategjike (OS), Objektivave Operacionale (OO) dhe Treguesve të Performancës (KPI) përfshihet në Shtojcën 3. Ky diagram ndihmon në kuptimin sistematik të arkitekturës së planifikimit të Fakultetit të Arteve për periudhën 2025–2030.

20. Mekanizmat e monitorimit dhe raportimit

Për të siguruar që zbatimi i Planit të Veprimit të ndjekë standardet e cilësisë dhe të matet në mënyrë të rregullt, Fakulteti i Arteve do të themelojë një Komision për Zhvillim Strategjik, i cili do të jetë përgjegjës për:

- Mbledhjen e të dhënave të performancës nga të gjitha njësitet akademike dhe administrative;
- Hartimin e raporteve vjetore të progresit dhe dorëzimin e tyre në Dekanat dhe Këshillin e Fakultetit;
- Monitorimin e indikatorëve të përfshirë në Planin e Veprimit dhe rekomandimin e ndërhyrjeve korrigjuese në rast devijimesh;
- Bashkëpunimin me Zyrën për Sigurimin e Cilësisë dhe me njësitet relevante të Universitetit të Prishtinës;
- Organizimin e rishikimit të ndërmjetëm të planit çdo dy vite dhe rishikimit të përgjithshëm në fund të ciklit strategjik.

Raportet e monitorimit do të shërbejnë gjithashtu si bazë për raportimin vjetor institucional dhe për dokumentacionin mbështetës gjatë procesit të akreditimeve dhe auditimeve të jashtme.

21. Monitorimi, vlerësimi dhe zbatueshmëria

21.1. Sistemi i monitorimit të objektivave strategjike

Zbatimi i Planit Strategjik mbështetet në një sistem të qartë dhe të strukturuar të monitorimit të objektivave. Për secilin objektiv strategjik dhe objektiv specifik janë përcaktuar treguesit kyç të performancës, burimet e të dhënave dhe njësitet përgjegjëse. Njësitet përkatëse (departamentet, dekanati, komisionet funksionale) mbledhin të dhëna në mënyrë periodike dhe raportojnë progresin në përputhje me procedurat institucionale. Sistemi lejon matjen objektive të arritjes, evidentimin e devijimeve dhe marrjen e masave korrigjuese për të garantuar zbatimin efektiv të strategjisë. Çdo veprim në Planin e Veprimit lidhet drejtpërdrejt me objektivat strategjike për të mundësuar ndjekje sistematike të progresit.

21.2. Mekanizmat dhe strukturat përgjegjëse për vlerësimin

Këshilli i Fakultetit ka përgjegjësi drejtues për zbatimin e strategjisë dhe emëron Komisionin për Monitorim dhe Vlerësim, i cili përbëhet nga stafi akademik, administrativ dhe përfaqësues të studentëve. Komisioni bashkëpunon me strukturat relevante dhe zyrat qendrore të UP-së për të grumbulluar të dhëna, vlerësuar progresin, adresuar sfidat dhe paraqitur rekomandime. Gjetjet e tij dokumentohen dhe i paraqiten menaxhmentit të Fakultetit për veprim të mëtutjeshëm.

21.3. Frekuenca e raportimit dhe përgjegjësitë

Mbledhja e të dhënave dhe raportimi kryhen në baza tremujore ose gjashtëmujore. Komisioni harton një raport vjetor të progresit, në bashkëpunim me Zyrën për Zhvillim Institucional të UP-së. Raporti përfshin të dhëna mbi aktivitetet e realizuara, efektet dhe ndikimet, vështirësitë e hasura, mësimet e nxjerra dhe rekomandimet për përmirësim. Ai i dorëzohet Këshillit të Fakultetit dhe nivelit qendror të universitetit për integrim në strategjitë institucionale.

Të gjitha raportet vjetore të monitorimit dhe vlerësimit do të dokumentohen dhe ruhen si pjesë e dosjes për akreditim institucional dhe programor. Ato do të shërbejnë si dëshmi për zbatimin efektiv të strategjisë dhe për përmirësimin e vazhdueshëm.

21.4. Rishikimi periodik dhe përmirësimi i planit

Strategjia i nënshtrohet rishikimit të rregullt vjetor dhe publikimit të rezultateve në web, pas analizës së progresit. Një vlerësim afatmesëm kryhet në vitin 2027/2028, dhe një vlerësim përfundimtar realizohet në fund të vitit 2030. Gjetjet përdoren për të përmirësuar objektivat dhe veprimet e ardhshme dhe për të hartuar strategjitë e radhës, në përputhje me standardet e KShC-së dhe praktikat më të mira.

21.5. Përfshirja e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm

Për të siguruar një strategji gjithëpërfshirëse dhe të orientuar drejt nevojave reale, në procesin e vlerësimit përfshihen stafi, studentët, alumnistët dhe përfaqësuesit e tregut të punës. Kontributet

mblidhen përmes pyetësorëve, konsultimeve dhe forumeve këshilluese dhe integrohen në analizat vjetore dhe veprimet e ardhshme.

21.6. Lidhja ndërmjet planit të veprimit dhe objektivave strategjike

Plani i Veprimit funksionon si mekanizëm praktik i zbatimit të strategjisë. Çdo objektiv strategjik shoqërohet me aktivitete konkrete, afate, përgjegjësi dhe indikatorë matës të lidhur me Planin e Veprimit dhe indikatorët e Planit të Zhvillimit. Komisioni për Monitorim dhe Vlerësim ndjek përmbushjen e këtyre aktiviteteve dhe, në rast devijimesh, propozon masa korrigjuese. Kjo lidhje vertikale siguron koherencë dhe efikasitet gjatë gjithë ciklit 2025–2030, duke ndërlidhur vizionin strategjik me zbatimin ditor.

Në rast të devijimeve nga arritja e objektivave strategjike apo performancës së planifikuar, Komisioni për Monitorim dhe Vlerësim, në bashkëpunim me Këshillin e Fakultetit, do të propozojë masa korrigjuese konkrete. Këto mund të përfshijnë rishikim të aktiviteteve, riorganizim të burimeve, ose shtyrje të afateve, sipas nevojës.

21.7. Tabela përmbledhëse e monitorimit dhe vlerësimit


Tabela në vijim përmbledh mekanizmat kyç të monitorimit dhe vlerësimit të planit strategjik, duke specifikuar përgjegjësitë, frekuencën dhe instrumentet që do të përdoren për secilin komponent të procesit.

Tabela e Mekanizmave të Monitorimit dhe Vlerësimit të Planit Strategjik

KOMPONENTI	PËRGJEGJËSIA	FREKUENCA	INSTRUMENTI / METODA	DOKUMENT REFERUES
Monitorimi i aktiviteteve	Njësitë përkatëse / Departamentet	Çdo 3–6 muaj	Raporte progresi, takime pune	Plani i Veprimit
Vlerësimi i objektivave	Komisioni për Monitorim dhe Vlerësim	Vjetore / Afatmesme	Raport vjetor, vlerësim i mesëm dhe/ose përfundimtar	Plani Strategjik
Përfshirja e akterëve	Këshilli i Fakultetit / Alumnistët / Partnerët	Vjetore / Sipas rastit	Pyetësorë, takime konsultative, tryeza të rrumbullakëta	Plani i Zhvillimit
Rishikimi i strategjisë	Këshilli i Fakultetit dhe Komisioni Strategjik	Vjetore dhe 2027 / 2030	Dokument i rishikuar strategjik, vendime dhe analiza	Plani Strategjik

22. Diagrami i procesit të monitorimit dhe vlerësimit

Në vijim paraqitet një diagram rrjedhjeje që vizualizon ciklin e monitorimit dhe vlerësimit të zbatimit të Planit Strategjik të Fakultetit të Arteve. Ky cikël përbëhet nga katër faza kryesore: mbledhja e të dhënave, vlerësimi i progresit, raportimi dhe rekomandimet, si dhe rishikimi periodik. Secila fazë është e lidhur me fazat e tjera për të siguruar përmirësim të vazhdueshëm në zbatim dhe përshtatshmëri me zhvillimet aktuale.



23. Ndikimi i parashikuar në shoqëri dhe kulturë

Zbatimi i Planit Strategjik 2025–2030 pritet të ketë ndikim të qëndrueshëm në jetën kulturore dhe shoqërore në Kosovë. Nëpërmjet reformave të thella akademike, avancimit të krijimtarisë dhe ndërlidhjes me komunitetin, Fakulteti i Arteve do të pozicionohet si një aktor kyç në zhvillimin kulturor dhe edukimin qytetar.

Ndikimi do të matet përmes:

- Përfshirjes së studentëve në jetën artistike publike dhe projektet komunitare;
- Kontributit të alumnistëve në sektorin kulturor vendor e ndërkombëtar;
- Bashkëpunimit të strukturuar me institucionet publike dhe OJQ-të kulturore;
- Ekspozimit të punës kërkimore dhe krijuese në rrjete evropiane dhe platforma akademike;
- Rritjes së qasjes së publikut në ngjarje artistike dhe edukative të organizuara nga Fakulteti.

Ky ndikim i synuar përforcon rolin transformues të Fakultetit si promotor i inovacionit kulturor dhe ndërveprimit social.

Për të matur ndikimin publik dhe rolin e Fakultetit në shoqëri, do të përdoren indikatorë si: numri i ngjarjeve të hapura për publikun, numri i pjesëmarrësve në ekspozita dhe koncerte, si dhe praninë e Fakultetit në media dhe rrjete sociale kulturore.

V. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

24. Përmbledhje përfundimtare e Planit Strategjik

Plani Strategjik i Fakultetit të Arteve 2025–2030 paraqet një vizion të qartë për zhvillimin institucional dhe akademik të kësaj njësie të rëndësishme të Universitetit të Prishtinës. Nëpërmjet këtij dokumenti, Fakulteti synon të konsolidojë cilësinë akademike, të promovojë krijimtarinë artistike dhe kërkimin, të avancojë ndërkombëtarizimin dhe të krijojë ura të qëndrueshme me komunitetin dhe tregun e punës.

Bazuar në analizën e brendshme dhe të jashtme, si dhe në procesin gjithëpërfshirës të planifikimit strategjik, Fakulteti ka përcaktuar pesë objektiva kyçe që do të udhëheqin zhvillimin në periudhën pesëvjeçare. Këto objektiva janë të mbështetura në strategji të qarta të zbatimit, të matshme dhe të realizueshme, të cilat do të monitorohen në mënyrë sistematike nga strukturat përgjegjëse.

25. Rekomandime për zbatim të suksesshëm dhe përshtatje të vazhdueshme

- **Mobilizimi i burimeve:** Të angazhohen të gjitha kapacitetet e brendshme dhe të jashtme për të siguruar fondet, ekspertizën dhe partneritetet e nevojshme për realizimin e strategjisë.
- **Forcimi i mekanizmave të vlerësimit:** Të garantohet funksionaliteti i Komisionit për Monitorim dhe Vlerësim dhe të përfshihet vazhdimisht komuniteti universitar në analizat periodike.
- **Përditësimi dhe fleksibiliteti i planit:** Të shqyrtohet çdo vit përmbajtja e planit strategjik dhe të bëhen përshtatje sipas nevojave të reja ose rrethanave të papritura.
- **Rritja e dukshmërisë:** Të sigurohet një komunikim i rregullt me publikun përmes raporteve, takimeve dhe përfaqësimit të aktiviteteve për të përforcuar imazhin dhe reputacionin e Fakultetit.
- **Zhvillimi profesional i stafit dhe studentëve:** Të promovohet një kulturë e të mësuarit të vazhdueshëm dhe të fuqizohen kapacitetet për menaxhimin dhe zbatimin efektiv të strategjisë.

Zbatimi i Planit Strategjik 2025–2030 përbën një mundësi reale për transformimin e Fakultetit të Arteve në një qendër të gjallë të edukimit, krijimtarisë dhe bashkëpunimit. Me përkushtim institucional, bashkëpunim ndër - sektorial dhe pjesëmarrje të gjerë të komunitetit akademik, kjo strategji do të bëhet një instrument kyç për zhvillim të qëndrueshëm dhe përmbushje të misionit akademik e shoqëror të Fakultetit.

25.1. Tabela e financimit indikativ për objektivat strategjike

OBJEKTIVI STRATEGJIK	BUXHETI INDIKATIV (€)	BURIMI KRYESOR I FINANCIMIT
OS1 – Cilësia	550,000	UP, donacione, Erasmus+
OS2 – Kërkimi	380,000	IPA, BE, partneritete ndërkombëtare
OS3 – Ndërkombëtarizimi	250,000	Erasmus+, rrjete evropiane
OS4 – Infrastrukturë	14,000,000	Buxhet shtetëror, donatorë, UP
OS5 – Përfshirja	75,000	UP, organizata të shoqërisë civile
TOTALI	15,255,000	

VI. SHTOJCAT (të strukturara sipas logjikës së përmbajtjes)

Shtojca 1: Plani strategjik për ndërtimin e kampusit të ri të fakultetit të arteve

Qëllimi i projektit

Kjo shtojcë pasqyron orientimin strategjik të Fakultetit të Arteve për ndërtimin e një kampusi të ri unik dhe funksional, i cili do të bashkojë në një hapësirë të vetme të gjitha departamentet dhe njësitë institucionale – Artet Vizuale, Muzikë dhe Dramë – duke tejkaluar fragmentimin fizik dhe mungesën e infrastrukturës adekuate.

Objekti është ndërtimi i një kompleksi modern artistik, të krahasueshëm me universitetet më të avancuara të arteve në Evropë, që do të ofrojë kushte optimale për mësimdhënie, krijimtari, performancë, kërkim dhe bashkëpunim ndërkombëtar, dhe të zhvillohet si hapësirë laboratorike bashkëkohore për arsimin artistik.

Përshkrimi i kampusit të ri (modular)

NJËSIA	PËRSHKRIMI I SHKURTËR
Departamenti i Arteve të Bukura	Studio për Pikturë, Skulpturë, Grafikë, Vizatim & Ilustrim, Arte Konceptuale dhe Multimediale
Departamenti i Muzikës	Dhomë Koncertale, Studio për Kompozim, Dhomë Pedagogjike, Klasë për Instrumente, Repart Kore
Departamenti i Dramës	Teatër i brendshëm me skenë të zezë, studio për aktrim, regji, dramaturgji, kamerë dhe montazh
Qendra për Kërkime dhe Inovacione	Laboratorë të avancuar për art digjital, zë, AI, eksperimente vizuale dhe art bashkëkohor
Biblioteka dhe Arkivi i Arteve	Literaturë bashkëkohore, fond multimedial, hapësira leximi dhe databazë digjitale të krijimtarisë
Zyrat institucionale dhe hapësirat sociale	Zyra akademike, administrative, kafe-kulturë, librari, “art shop” për publikun, ambiente relaksuese

Faza të zbatimit dhe afatet kohore

FAZA	PËRMBAJTJA	AFATI I PLANIFIKUAR
Faza I – Projektimi	Konkursi ndërkombëtar për projektin arkitektonik	2025
Faza II – Sigurimi i buxhetit	Aplikime për fonde, buxhet shtetëror, donatorë strategjikë	2025–2026
Faza III – Ndërtimi	Realizimi në 2 faza: 1) Artet Vizuale; 2) Muzika dhe Drama	2026–2029
Faza IV – Funksionalizimi	Pajisja, rekrutimi dhe zhvendosja e departamenteve	2029–2030

Buxheti indikativ dhe burimet e financimit

KATEGORIA	VLERA E PËRLLOGARITUR (€)	BURIMI
Projektimi	250,000	UP, donacione, projekte BE
Ndërtimi	12,000,000	Buxheti shtetëror, MASHTI, partnerë
Pajisjet dhe teknologjia	1,500,000	UP, BE, fonde IPA, Erasmus+
Galeria + hapësirat kreative	500,000	UP, MASHTI, MKRS, fonde kulturore
Laboratorë dhe studio	750,000	Rrjete artistike, projekte kërkimore
TOTALI	15,000,000 €	

Vlera strategjike për Fakultetin dhe shoqërinë

- Bashkimi i të gjitha njësive në një kompleks të përbashkët do të eliminojë pengesat fizike, organizative dhe krijuese.
- Kampusi do të jetë model për bashkëpunim ndërdisiplinor ndërmjet arteve pamore, muzikës dhe dramës.
- Do të krijojë kushte për diplomaci kulturore, bashkëprodhime ndërkombëtare dhe qasje moderne në edukimin artistik.
- Shërben si qendër kulturore për qytetin dhe më gjerë.
- Kampusi do të ofrojë mundësi qasjeje për personat me aftësi të kufizuara, qasje të lirë në art dhe do të gjenerojë ndikim social.

Shtojca 2: Qasja e fakultetit të arteve ndaj barazisë gjinore dhe përfshirjes

Parimet themelore

Fakulteti i Arteve është i përkushtuar ndaj promovimit të barazisë gjinore, përfshirjes sociale dhe respektimit të diversitetit kulturor, gjinor, etnik dhe socio-ekonomik në të gjitha nivelet e funksionimit të tij akademik dhe institucional. Ky angazhim është në përputhje me politikat e Universitetit të Prishtinës dhe standardet e Bashkimit Evropian për institucionet e arsimit të lartë.

Objektivat e barazisë dhe përfshirjes

- Të sigurohet qasje e barabartë në arsim dhe mundësi akademike për të gjitha gjinitë.
- Të krijohen kushte të sigurta, gjithëpërfshirëse dhe pa diskriminim për të gjithë studentët dhe stafin.
- Të promovohet përfaqësimi i balancuar gjinor në trupin akademik dhe në pozitat drejtuese.
- Të integrohet perspektiva gjinore në përmbajtjet mësimore dhe projektet kërkimore.
- Të përfaqësohen gratë dhe burrat në të gjitha komisionet dhe strukturat me së paku 40 përqind.

Veprimet konkrete

FUSHA E NDIKIMIT	MASA KONKRETE	AFATI	PËRGJEGJËSIA	DOKUMENT REFERUES
Politikat institucionale	Hartimi i një politike të brendshme për barazi dhe përfshirje	2025	Këshilli i Fakultetit	Udhëzuesi për Barazi dhe Përfshirje
Edukimi dhe ndërgjegjësimi	Trajnime për staf dhe studentë mbi barazinë gjinore dhe të drejtat	2025–2026	Dekanati, Koordinator i Barazisë	Plani i Veprimit për Barazi Gjinore
Përfaqësimi	Monitorimi i përfaqësimit gjinor në komisione dhe struktura vendimmarrëse	Çdo vit	Sekretaria dhe Dekanati	Raportet Vjetore të Fakultetit
Kërkimi shkencor	Inkurajimi i temave kërkimore mbi barazinë dhe diversitetin	Vazhdimisht	Departamentet	Politika e Kërkimit të Fakultetit
Raportimi dhe vlerësimi	Raport vjetor për progresin në barazi dhe përfshirje	Vjetor	Zyra për Sigurimin e Cilësisë	Mekanizmat e Monitorimit dhe Vlerësimit

Partneritetet dhe përputhshmëria

Fakulteti i Arteve synon të bashkëpunojë me rrjete vendore dhe ndërkombëtare për barazi gjinore në arsim, si dhe të harmonizojë politikat e veta me agjendat e UNESCO-s, UN Women, dhe Erasmus+ për inkluzion dhe diversitet.

Përfshirja në planin strategjik dhe veprimin institucional


Qasja ndaj barazisë gjinore dhe përfshirjes do të jetë pjesë integrale e objektivave strategjike të Fakultetit të Arteve dhe do të reflektohet në:

- Politikat e pranimi të studentëve
- Rekrutimin dhe avancimin e stafit
- Krijimin e një kulture të qëndrueshme të respektit dhe barazisë në ambientet e fakultetit

Kjo shtojcë është pjesë përbërëse e Planit Strategjik 2025–2030 dhe do të zbatohet në përputhje me Planin e Veprimit për periudhën përkatëse.

Shtojca 3: Diagrami i lidhjes ndërmjet OS–OO–KPI

Ky diagram paraqet arkitekturën logjike të Planit Strategjik të Fakultetit të Arteve, duke ilustruar mënyrën se si Objektivat Strategjike (OS) zbërthehen në Objektiva Operacionale (OO), dhe më pas në Tregues të Performancës (KPI), të cilët janë të përkthyer në veprime konkrete në Planin e Veprimit 2025–2030.



Shtojca 4- Përmbledhje vizuale e strategjisë

Vizioni

Fakulteti i Arteve synon të jetë qendër lider e arsimit artistik, kërkimit krijues dhe diplomacisë kulturore në rajon, duke kontribuar në zhvillimin kulturor dhe edukativ të shoqërisë përmes inovacionit, përfshirjes dhe cilësisë.

5 Objektivat Strategjike

OS1 – Cilësia Akademike

Rritja e cilësisë së mësimdhënies, kurrikulave dhe përvojës studentore.

OS2 – Kërkimi dhe Inovacioni

Zhvillimi i kapaciteteve kërkimore, projekteve dhe publikimeve.

OS3 – Infrastruktura

Zhvillimi i kampusit të ri dhe kushteve bashkëkohore për mësim dhe krijimtari.

OS4 – Ndërkombëtarizimi

Thellimi i partneriteteve ndërkombëtare dhe rritja e mobilitetit akademik.

OS5 – Alumni dhe Komuniteti


Fuqizimi i rrjeteve të alumnistëve dhe ndikimi i Fakultetit në komunitet.

Kjo përmbledhje vizuale ofron një pamje të qartë të prioriteteve strategjike të Fakultetit të Arteve për periudhën 2025–2030 dhe mund të përdoret për komunikim publik, web institucional dhe takime me partnerë.

Shtojcë 5: Lidhja ndërmjet objektivave strategjike, objektivave operacionalë dhe fushave kryesore tematike

Ky diagram paraqet lidhjen logjike ndërmjet pesë Objektivave Strategjike (OS) të Planit Strategjik 2025–2030 të Fakultetit të Arteve dhe Objektivave Operacionalë (OO) përkatës, të ndërlidhura me fushat tematike kryesore që udhëheqin zbatimin e strategjisë. Kjo strukturë ndihmon në koordinimin ndërmjet planifikimit institucional dhe prioriteteve zhvillimore ndërdisiplinore.

Diagrami Kreativ i Objektivëve Strategjikë, Operacionalë dhe Fushave Kryesore




Shtojca 6: Fjalor termash

TERMI	PËRKUFIZIMI
Aneks	Term i ngjashëm me shtojcën, por përdoret më shumë në dokumentet operative dhe planifikuese si Plani i Veprimit dhe Plani i Zhvillimit.
Barazi Gjinore	Promovimi i kushteve të barabarta për të gjitha gjinitë në të gjitha aspektet e arsimit, punësimit dhe përfaqësimit institucional.
Diplomaci Kulturore	Aktivitetet ndërkombëtare që promovojnë vlerat artistike dhe kulturore përmes bashkëpunimit, shkëmbimit dhe përfaqësimit të institucioneve të artit.
Edukimi dhe Ndërgjegjësimi	Veprimtari informuese dhe trajnime që synojnë ngritjen e vetëdijes për çështje të rëndësishme si barazia, të drejtat, përfshirja dhe diskriminimi.
ESG (European Standards and Guidelines)	Udhëzues evropian për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë që përcakton standardet për planifikim, implementim dhe vlerësim të cilësisë në institucione.
Fakulteti i Arteve (UP)	Njësi akademike e Universitetit të Prishtinës që përfshin tri departamente: Arte Vizuale, Muzikë dhe Dramë.
Indikator KPI	Njësi matëse e caktuar për një KPI, e cila përfaqëson të dhënat që përdoren për të gjurmuar progresin (p.sh. përqindje, numër i arritur, ndryshim vjetor).
Kampus Universitar	Kompleks i përbashkët fizik ku bashkohen të gjitha njësitë akademike, krijuese dhe administrative të një institucioni të arsimit të lartë.
KPI (Key Performance Indicator)	Tregues kyç të performancës; përdoren për të matur arritjen e objektivave përmes të dhënave konkrete, statistikave ose progresit të matshëm.
Monitorim Vjetor	Proces i rregullt një herë në vit për të shqyrtuar zbatimin e masave të planifikuara dhe për të raportuar progresin drejt objektivave.
Objektiv Operacional	Veprim konkret i planifikuar për të realizuar një objektiv strategjik; i matshëm dhe i ndërlidhur me afate, përgjegjësi dhe burime.
Objektiv Specifik	Nënndarje më e fokusuar e një objekti operacional që lejon matje të detajuar dhe veprime të drejtpërdrejta për arritjen e tij.
Objektiv Strategjik	Qëllim madhor afatgjatë i fakultetit, i cili udhëheq politikën, programet dhe alokimin e burimeve gjatë gjithë periudhës strategjike.
Plan Strategjik	Dokument afatgjatë i orientuar drejt objektivave institucionale, që përcakton prioritetet kryesore, drejtimet zhvillimore dhe masat për zbatim sistematik.
Qasja Gjithëpërfshirëse	Parim që synon përfshirjen aktive të të gjitha grupeve, pa përjashtim, në jetën akademike dhe vendimmarrjen institucionale.
Qëndrueshmëri Institucionale	Kapaciteti i institucionit për të ruajtur dhe zhvilluar funksionet e veta akademike, organizative dhe financiare në mënyrë të qëndrueshme dhe afatgjatë.
Rrjetëzim Akademik	Lidhja dhe bashkëpunimi i fakultetit me institucione, universitete, organizata dhe rrjete ndërkombëtare për zhvillim të përbashkët akademik dhe krijues.
Shtojcë	Pjesë shtesë në fund të dokumentit që përmban të dhëna plotësuese, plane teknike, projekt-propozime, ose specifikime tematike që mbështesin përmbajtjen.
Strategji Institucionale	Qasje e përbashkët, e planifikuar dhe e miratuar për drejtimin dhe zhvillimin afatgjatë të institucionit në fusha të ndryshme (arsim, kërkim, shërbime).
UP (Universiteti i Prishtinës)	Institucioni publik i arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor në Kosovë, që ofron programe studimi në fusha të ndryshme akademike.

Shtojca 7: Grafikët vizualë të zbatimit të objektivave strategjikë (2025–2030)

(Plani kohor i implementimit për çdo objektiv strategjik, i paraqitur në mënyrë vizuale)




**Objektivi
Strategjik**

4

NDËRKOMBËTARIZIMI

OS4 - Ndërkombëtarizimi (Plani i Zbatimit: 2025-2030)




**Objektivi
Strategjik**

5


ALUMNI DHE KOMUNITETI

OS5 - Alumni dhe Komuniteti (Plani i Zbatimit: 2025-2030)



PLANI STRATEGJIK PËR NDËRTIMIN E KAMPUSIT TË RI TË FAKULTETIT TË ARTEVE

OS6 - Plani Strategjik për Ndërtimin e Kampusit të Ri të Fakultetit të Arteve (Plani i Zbatimit: 2025-2030)



Shtojca 8: Angazhimi i fakultetit për zbatim, qëndrueshmëri dhe vizion

Plani Strategjik i Fakultetit të Arteve 2025–2030 përfaqëson një dokument gjithëpërfshirës zhvillimi dhe vizioni për një institucion artistik që aspiron të jetë model në nivel kombëtar dhe konkurrues në skenën evropiane të arsimit të lartë.

Ky plan është rezultat i një procesi të thellë institucional, që përfshiu analizë të brendshme, konsultim me aktorët kryesorë të fushës, studentë, staf akademik e administrativ, si dhe orientim drejt standardeve të institucioneve më të përparuara ndërkombëtare.

Zbatimi i këtij plani do të udhëhiqet nga Dekanati dhe Këshilli i Fakultetit, në koordinim të plotë me të gjitha njësitë përbërëse, duke siguruar monitorim, raportim dhe përmirësim të vazhdueshëm institucional.

Fakulteti i Arteve mbetet i përkushtuar për të ndërtuar një ambient gjithëpërfshirës, krijues dhe të qëndrueshëm, në funksion të zhvillimit të talenteve të reja dhe përforsimit të rolit të artit në emancipimin e shoqërisë bashkëkohore.

Qëndrueshmëria institucionale dhe përkushtimi për të ardhmen

Fakulteti i Arteve angazhohet për zhvillim të qëndrueshëm strategjik, përmes përgatitjes së brezit të ri të stafit akademik, rritjes së fondeve për kërkim, dhe rishikimit periodik të strategjisë në vitin 2027 dhe 2030. Qëllimi është ruajtja e lidërshit në arsimin artistik dhe diplomacinë kulturore në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Deklaratë Institucionale mbi Përdorimin dhe Rishikimin e Dokumentit

Plani Strategjik i Fakultetit të Arteve të Universitetit të Prishtinës për periudhën 2025–2030 është një dokument zyrtar i miratuar nga organet kompetente të Fakultetit dhe i harmonizuar me politikat zhvillimore të Universitetit të Prishtinës, si dhe me standardet kombëtare dhe evropiane për arsimin e lartë.

Dokumenti i nënshtrohet rishikimeve të rregullta periodike në përputhje me ndryshimet institucionale, zhvillimet arsimore dhe kulturore në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, si dhe me gjetjet e mekanizmave të brendshëm të monitorimit dhe vlerësimit.

Plani Strategjik është pronë institucionale e Fakultetit të Arteve dhe mbrohet nga dispozitat përkatëse ligjore. Çdo riprodhim, shpërndarje, publikim apo përdorim i këtij dokumenti, në tërësi ose në pjesë, kërkon autorizim të shkruar paraprak nga autoritetet përkatëse të Fakultetit të Arteve.